

BRITISH AMERICAN TOBACCO ALBANIA SH.P.K.

Pasqyrat Financiare Sipas Standardeve Ndërkombëtare Të Raportimit Financiar

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

Përmbajtja	
Raporti i audituesit të pavarur	iii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
1. Informacion mbi Shoqërinë	5
2. Baza e përgatitjes	5
3. Përmbledhja e politikave kryesore kontabël	6
3.1. Konvertimi i monedhave të huaja	6
3.2. Aktivët afatgjatë materiale	6
3.3. Inventarët	6
3. Përmbledhja e politikave kryesore kontabël (vazhdim)	7
3.4. Instrumentet financiare	7
3.5. Llogaritë e arkëtueshme	7
3.6. Parapagimet	7
3. Përmbledhja e politikave kryesore kontabël (vazhdim)	8
3.6. Mjetet monetare	8
3.7. Zhvlerësimi	8
3.9. Kapitali aksionar	8
3.10. Provizionet	9
3.11. Llogaritë e pagueshme	9
3.12. Huamarrjet	9
3.13. Të ardhurat nga shitja	9
3.13.1. Të ardhura nga shitja e mallrave	9
3.13.2. Komisionet	9
3.14. Përfitimet e punonjësve	9
3.15. Qiratë	9
3.16. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	10
3.17. Kompensimi	10
3.18. Tatimi mbi fitimin	10
3.19. Ndryshime në paraqitje	10
4. Menaxhimi i rrezikut financiar	11
4.1. Procedurat dhe politikat e menaxhimit të rrezikut	11
4.2. Rreziku financiar	11
4.2.1. Rreziku i tregut	11
4.2. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)	12
4.2. Rreziku financiar (vazhdim)	12
4.2. Rreziku financiar (vazhdim)	12
4.2.3. Rreziku i normës së interesit (vazhdim)	13
4.3. Rreziku i kreditimit	13
4.4. Rreziku i likuiditetit	14
4.5. Menaxhimi i kapitalit	15
5. Përdorimi kritik i gjykimeve dhe vlerësimeve në zbatimin e politikave kontabël	16
5.1. Njohja e të ardhurave	16
5.2. Njohja e aktivit të shtyrë tatimor	16
5.3. Parimi i vijmësisë	16
5.4. Llogaritë e arkëtueshme - zhvlerësimi	16
6. Standardet e reja dhe interpretimet	17
7. Aktivët afatgjatë materiale	20
8. Aktiv i shtyrë tatimor	21
9. Inventarët	21
11. Llogari të tjera të arkëtueshme	22
12. Mjetet monetare dhe ekuivalente	22
13. Kapitali aksionar	23
14. Huatë	23
15. Llogari të pagueshme	23
15. Llogari të pagueshme (vazhdim)	24
16. Detyrime të tjera	24
17. Të ardhurat nga shitjet	24
18. Kosto e mallrave të shitur	24
19. Shpenzime tregtare dhe marketingu	24
20. Shpenzimet administrative	25
21. Të ardhura të tjera operative	25
22. Shpenzimet financiare neto	25
23. Tatimi mbi fitimin	25
24. Angazhime dhe detyrime të mundshme	26
25. Transaksione me palët e lidhura	26
25. Transaksione me palët e lidhura (vazhdim)	27
26. Ngjarjet pas datës së raportimit	27

Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
AKTIVET			
Aktivitet afatgjata			
Aktivitet afatgjata materiale	7	26,203,141	27,670,144
Totali i aktiveve afatgjata		26,203,141	27,670,144
Aktivitet afatshkurtra			
Inventari	9	3,524,111	1,928,340
Llogari të arkëtueshme	10	902,388,894	1,491,905,892
Tatim fitimi i arkëtueshëm	23	948,742	3,228,946
Të tjera llogari të arkëtueshme	11	76,467,564	77,289,168
Mjete monetare	12	338,747,962	2,151,787
Totali i aktiveve afatshkurtra		1,322,077,273	1,576,504,133
Totali i aktiveve		1,348,280,414	1,604,174,277
KAPITALI NETO			
Kapitali i paguar	13	552,341,000	552,341,000
Humbje të mbartura		(177,196,419)	(177,885,297)
Totali i kapitalit		375,144,581	374,455,703
DETYRIMET			
Detyrimet afatgjata			
Huatë	14	-	552,273,071
Totali i detyrimeve afatgjata		-	552,273,071
Detyrimet afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	15	111,688,174	626,209,287
Detyrime të tjera	16	96,157,443	51,236,216
Tatim fitimi i pagueshëm	14	765,290,216	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		973,135,833	677,445,503
Totali i detyrimeve		973,135,833	1,229,718,574
Totali i detyrimeve dhe kapitali		1,348,280,414	1,604,174,277

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues më 12 Gusht 2015 dhe janë nënshkruar në emër të tij si më poshtë:



Generali Director
Greta Xhaferriaj



Finance Manager
Brunilda Bakiri

British American Tobacco Albania sh.p.k.

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
	Shënime	2014	2013
Të ardhurat nga shitja	17	1,716,736,152	2,338,549,941
Minus: Komisioni i distributorit	17	(369,038,600)	(420,758,962)
Të ardhurat neto nga shitjet		1,347,697,552	1,917,790,979
Kosto e mallrave të shitura	18	(1,123,208,311)	(1,607,276,936)
Fitimi bruto		224,489,241	310,514,043
Shpenzime tregtare dhe marketingu	19	(53,685,407)	(188,906,393)
Shpenzime administrative	20	(120,763,329)	(150,969,207)
Të ardhura të tjera operacionale	21	3,825,133	3,259,311
Rezultati i veprimtarisë operative		53,865,638	(26,102,246)
Shpenzime financiare -neto	22	(41,833,870)	(28,317,593)
(Humbja)/fitimi para tatimit		12,031,768	(54,419,839)
Tatim fitimi	23	(11,342,890)	(6,686,166)
(Humbja)/fitimi i vitit		688,878	(61,106,005)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i (humbjeve)/të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		688,878	(61,106,005)

Shënimet nga faqet 5 – 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

	Kapitali aksionar	Humbje të mbartura	Totali i kapitalit
Më 1 janar 2013	552,341,000	(116,779,292)	435,561,708
Fitimi i vitit	-	(61,106,005)	(61,106,005)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<i>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin</i>	-	(61,106,005)	(61,106,005)
Më 31 dhjetor 2013	552,341,000	(177,885,297)	374,455,703
Më 1 janar 2014	552,341,000	(177,885,297)	374,455,703
Fitimi i vitit	-	688,878	688,878
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
<i>Totali i të humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin</i>	-	688,878	-
Më 31 dhjetor 2014	552,341,000	(177,196,419)	375,144,581

Shënime	Për vitin e mbyllur më	
	2014	2013
Fluksi i parave nga veprimtaritë e shfrytëzimit (Humbja)/fitimi para tatimit		
Rregullime për:	12,031,768	(54,419,839)
Shpenzime amortizimi		
Shpenzime interesi	7	9,591,823
Të ardhura nga interesi	22	8,734,732
Provizione për llogaritë e arkëtueshme	22	35,205,858
Fitimi nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	10	27,977,978
Fluksi operativ nga veprimtaritë e shfrytëzimit para ndryshimeve në kapitalin qarkullues	21	(1,716,269)
Pakësimi i inventarit		-
Rritje e llogarive të arkëtueshme dhe të drejtave të tjera		-
Rritje llogarive të pagueshme dhe detyrimeve të tjera		
Fluksi monetar nga veprimtaria e shfrytëzimit		
Interesi i arkëtuar		
Interesi i paguar	22	(469,599,886)
Tatim-fitimi i paguar		95,035,011
Fluksi neto (i përdorur)/krijuar nga veprimtaria e shfrytëzimit		
	174,149,089	(98,344,597)
	1,614,972	1,716,269
	(35,928,713)	(24,956,689)
	(9,062,686)	(11,887,040)
	134,286,038	(133,472,057)
Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale		
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	7	(8,224,333)
Fluksi neto i përdorur në veprimtaritë e investimit		
		(6,211,739)
	307,846	-
	(7,916,487)	(6,211,739)
Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare		
Disbursime		
Ripagesa	14	353,940,000
Fluksi neto i përdorur në veprimtaritë financiare	14	-
		-
		-
	210,226,624	-
(Ulja)/ Rritja neto e mjeteve monetare		
Mjetet monetare më 1 janar		
Mjete monetare më 31 dhjetor		
	336,596,175	(139,683,796)
	2,151,787	141,835,583
	338,747,962	2,151,787

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

1. Informacion mbi Shoqërinë

British American Tobacco Albania sh.p.k. ("Shoqëria") është themeluar si një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Tiranë më 15 tetor 2001. Shoqëria zotërohet 100% nga British American Tobacco International Holdings B.V., e cila e ka selinë e saj në Hollandë. Shoqëria mëmë përfundimtare është British American Tobacco plc. ("Grupi"), që është Shoqëria mëmë kontrolluese e vendosur në Londër, Mbretëria e Bashkuar.

Aktiviteti kryesor

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është importi, marketingu dhe shitja me shumicë e cigareve me markën e British American Tobacco, në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria operon nën kornizën e strategjisë së grupit dhe objektivave për Shqipërinë dhe rajonin e Ballkanit duke përfshirë Bosnjë Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë dhe Slloveninë. Ajo financohet në pjesën më të madhe nga Shoqëri të tjera brenda grupit. Transaksionet me palët e lidhura janë detajuar në shënimin shpjegues 25.

Adresa e regjistruar dhe vendi i biznesit

Zyra e regjistruar e Shoqërisë ndodhet në Rruga e Kavajës, Ish Kombinati Ushqimor, Tiranë, Shqipëri.

2. Baza e përgatitjes

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë si me poshtë. Këto politika janë zbatuar në të gjitha vitet e paraqitura, nëse nuk specifikohet ndryshe.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9228 më datë 29 prill 2004. Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e metodës së kostos historike.

Pasqyrat financiare janë prezantuar në Lekë Shqiptar (Lekë), e cila është monedha funksionale kryesore e mjedisit ekonomik në të cilin Shoqëria, dhe monedha e prezantimit të Shoqërisë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtuesit të bëjnë vlerësime kontabël të rëndësishme. Elementët e pasqyrave financiare që kërkojnë një nivel më të lartë gjykimi ose subjektiviteti dhe për të cilat supozimet dhe gjykimet kanë influencë më të lartë janë shpjeguar në shënimin shpjegues 5.

Parimi i vijimësisë

Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimësisë, parim i cili presupozon që Shoqëria do të realizojë/arkëtojë aktivet dhe do të shlyejë detyrimet në rrjedhën normale të aktivitetit sipas maturiteteve përkatëse në të ardhmen e parashikueshme.

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2014, Shoqëria fitim neto prej 689 mijë Lekë (2013: realizoi një humbje prej 61,106 mijë Lekë) dhe 134,286 mijë Lekë flukse hyrëse nga veprimtaria e shfrytëzimit (2013: 133,472 mijë Lekë flukse dalëse nga veprimtaria e shfrytëzimit). Humbjet e akumuluar të Shoqërisë në 31 dhjetor 2014 zbriten në shumën 177,196 mijë Lekë.

Drejtimi është i besimit që përgatitja e pasqyrave financiare në bazë të parimit të vijueshmërisë është e përshtatshme duke marrë parasysh rezultatin e vitit, buxhetet dhe planet e biznesit të Shoqërisë dhe mbështetjen financiare të Grupit.

Gjithashtu mbas përfundimit të vitit borxhi i Shoqërisë prej 765,290,216 marrë nga British American Tobacco Western Europe Region B.V. (BAT WER B.V.) me maturim në 29 Prill 2015 është rinovuar për një vit tjetër. Maturimi i ri është në 29 Prill 2016.

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

3. Përmbledhja e politikave kryesore kontabël
3.1. Konvertimi i monedhave të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të mbajtura në monedhë të huaj në datën e raportimit, konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportit. Fitimet ose humbjet nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të huaj si dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhë të huaj me kursin e fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e balancave në monedhë të huaj, në datën e raportimit, janë si më poshtë:

2014	Euro	GBP
Kursi i këmbimit në fund të vitit	140.14	179.48
Kursi mesatar i këmbimit	139.97	173.47
2013		
Kursi i këmbimit në fund të vitit	140.20	168.39
Kursi mesatar i këmbimit	140.27	165.18

3.2. Aktivet afatgjata materiale

Aktivt afatgjata materiale mbahen me kosto historike duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja historike përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me koston e blerjes së aktivit. Kostot e mëpasshme përfshihen në vlerën kontabël të aktivit afatgjatë material ose njihen si aktiv më vete vetëm nëse është e mundshme që Shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me aktivin në fjalë dhe kostoja e tij të mund të matet në mënyrë të besueshme. Të gjithë shpenzimet e tjera të mirëmbajtjeve dhe riparimeve njihen në fitim/humbje në momentin që ato ndodhin. Shoqëria nuk ka në pronësi ndonjë truall apo ndërtesë. Amortizimi llogaritet në mënyrë lineare për të shpërndarë koston e aktiveve afatgjata materiale përgjatë jetës së tyre të dobishme. Amortizimi fillon të njihet në muajin pas atij të blerjes. Jetët e dobishme të zbatuara janë si në vijim.

Përshkrimi i kategorisë

	Vitet
Pajisje zyre dhe mobilja	
Pajisje elektronike	5
Mjete transporti	4
Instalim dhe pajisje	5
	5

Jeta e dobishme dhe vlera e mbetur e aktivit rishikohet dhe rregullohet, nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi. Vlera kontabël e një aktivit zvogëlohet menjëherë deri në vlerën e tij të rikuperueshme nëse vlera e mbetur e tij tejkalon këtë vlerë.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale njihen në zërin 'Të ardhura të tjera operationale' në fitim ose humbje.

3.3. Inventarët

Inventarët maten me më të ultën midis koston dhe vlerës së realizueshme neto. Kostoja e inventarëve llogaritet me metodën FIFO (hyn i pari, del i pari), dhe përfshin të gjithë shpenzimet e ndodhura gjatë blerjes dhe koston e tjera që nevojiten për ta sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese duke përfshirë koston e banderolave të blera nga Dogana Shqiptare në lidhje me akcizën e produktit. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes gjatë veprimtarisë normale të biznesit pakësuar me koston e vlerësuar të përfundimit dhe shpenzimet e shitjes.

3. Përmbledhja e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.4. Instrumentet financiarë

Instrumentet financiar mbahen në vlerën e drejtë ose me koston e amortizuar të përshkruar më poshtë, në varësi të klasifikimit të tyre.

Vlera e drejtë është shuma me të cilën aktivi mund të këmbëhet, ose detyrimi të shlyhet, midis palëve të mirëinformuara dhe me vullnet për pjesëmarrje në një transaksion që kryhet në kushtet e tregut. Kostoja e amortizuar është shuma me të cilën instrumentet financiar janë regjistruar në njohjen fillestare minus pagesat e principalit, plus interesi i përlogaritur, dhe për aktivet financiare minus çdo çregjistrim nga zhvlerësimi.

Shoqëria i klasifikon aktivet aktuale financiare si llogari të arkëtueshme. Kategoritë e tjera që merren në konsideratë për klasifikim janë aktivet financiare të disponueshme për shitje, aktivet financiare të mbajtura deri në maturim dhe aktivet financiare me vlerë të drejtë në fitim/humbje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin këto investime janë kryer. Drejtimi do të përcaktojë klasifikimin e investimeve në momentin e njohjes fillestare dhe do të rivlerësojë këtë paraqitje çdo datë raportimi.

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivativë me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Ato janë të përfshira në aktivet afatshkurtra, përveç atyre aktiveve që kanë maturim më të madh se 12 muaj pas datës së raportimit të cilat klasifikohen si aktive afatgjata. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë përfshijnë llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme.

Klasifikimi i detyrimeve financiare

Detyrimet financiare klasifikohen si në vazhdim: (a) të mbajtura për tregtim duke përfshirë derivativët financiarë dhe (b) detyrime financiare të tjera. Shoqëria ka vetëm detyrime financiare të tjera që mbahen me kosto të amortizuar (detyrime të tjera financiare).

Njohja e instrumenteve financiare

Instrumentet financiare të Shoqërisë (huatë dhe llogaritë e arkëtueshme) regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë duke shtuar dhe kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në regjistrimin fillestar evidentohet me çmimin e transaksionit. Humbja apo fitimi në regjistrimin fillestar regjistrohet vetëm nëse ka diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit, e cila mund të evidentohet nga transaksionet e të njëjtave instrumenta në treg ose nga metoda të vlerësimit për të cilën inputet përfshijnë vetëm të dhëna nga tregu.

Çregjistrimi i aktiveve financiare

Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) aktivet janë arkëtuar ose të drejtat për fluksin e të ardhurave nga aktivet maturojnë ose (b) Shoqëria ka transferuar të drejtat e fluksit të të ardhurave nga aktivet financiare ose ka ndërmarrë një marrëveshje të kalimit të instrumenteve duke (i) transferuar në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) duke mos kaluar rreziqet dhe përfitimet e aktiveve por duke mos mbajtur kontroll mbi to. Kontrolli mbahet nëse pala tjetër nuk ka aftësitë për të shitur aktivet tek një palë e tretë pa imponuar kufizime shtesë në shitje.

3.5. Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë shuma që klientët i detyrohen Shoqërisë për mallrat e shitura gjatë vazhdimësisë normale të biznesit. Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv pakësuar me provizionin për zhvlerësim.

3.6. Parapagimet

Parapagimet mbahen me koston fillestare duke zbritur provizionin për zhvlerësim. Paragimi klasifikohet si afatgjatë kur të mirat ose shërbimet për të cilat është kryer parapagimi priten të përfitohen pas më shumë se një viti, ose kur parapagimet janë për një aktiv i cili do të klasifikohet si afatgjatë në momentin e regjistrimit. Parapagimet për aktivet transferohen në vlerën e mbartur të aktivit në çastin kur Shoqëria zotëron aktivin dhe është e mundshme që të ardhurat që do të gjenerohen nga ky aktiv do të përfitohen nga Shoqëria. Paragime të tjera kalojnë si fitime ose humbje kur të mirat ose shërbimet për të cilat parapagimet janë bërë përfitohen nga Shoqëria. Nëse ka ndonjë të dhënë që aktivi, të mirat ose shërbimet për të cilat parapagimet janë bërë, nuk do të përfitohen nga Shoqëria, parapagimi çregjistrohet përkatësisht dhe humbja ose fitimi përkatës nga zhvlerësimi njihet në fitimin ose humbjen e vitit.

3. Përmbledhja e politikave kryesore kontabël (vazhdim)

3.6. Mjetet monetare

Mjetet monetare përbëhen nga paraja në arkë, llogaritë rrjedhëse në banka dhe depozitat afatshkurtra të mbajtura në banka. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.7. Zhvlerësimi

3.8.1. Aktivet financiare

Një aktiv financiar vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive për zhvlerësimin e tij. Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare individualisht të rëndësishme rishikohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim/humbje. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të vlerësuar me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në fitim/humbje.

3.8.2. Aktivet jo-financiare

Vlera kontabël neto e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë, përveç inventarëve dhe aktiveve të shtyra tatimore, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse të dhëna të tilla ekzistojnë, atëherë përllogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e një njësie gjeneruese monetare është më e madhja midis vlerës në përdorim të aktivit dhe vlerës së tij të drejtë minus koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parasë skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një përqindje skontimi para taksave, që pasqyron vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

Me qëllim që të testohen zhvlerësimet, aktivet grupohen së bashku në grupin më të vogël të aktiveve që gjenerojnë flukse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm dhe që janë të pavarur nga flukset monetare të aktiveve të tjera ose grupeve të aktiveve (njësia gjeneruese monetare).

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me njësitë gjeneruese monetare shpërndahen për të reduktuar vlerën kontabël të aktiveve në këtë njësi (ose grup njësisish) në bazë përpjestimore.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat paraardhëse vlerësohen në çdo datë raportimi për ndonjë të dhënë që tregon se humbja është ulur ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi do të rimerret nëse ka ndodhur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret në atë masë që vlera kontabël e aktiveve nuk tejkalon vlerën kontabël minus amortizimin që do të ishte përcaktuar nëse humbjet nga zhvlerësimi nuk do të ishin njohur.

3.9. Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme të emetuara klasifikohen si kapital aksionar. Kostot shtesë që i atribuohen emetimit të aksioneve të reja pasi janë zbritur taksat, paraqiten në kapital si zbritje nga kapitali i arkëtuar. Çdo shtesë e vlerës së drejtë të përfituar mbi vlerën fillestare regjistrohët si prim në kapital.

3. Përmbledhja e politikave kryesore kontabël (vazhdim)
3.10. Provizionet

Provizionet për detyrimet dhe shpenzimet janë detyrime jo-financiare me kohëzgjatje dhe vlerë të pasigurt. Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri, dhe ka mundësi që flukse dalëse të përfitimeve ekonomike do të jenë të nevojshme për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të parasë me një normë para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të detyrimit.

3.11. Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme janë detyrime për të paguar për të mirat apo shërbimet që janë blerë gjatë vazhdimësisë normale të biznesit nga furnitorët. Llogaritë e pagueshme klasifikohen si detyrime afatshkurtra nëse shlyerja e tyre duhet të kryhet brenda një viti apo më pak (ose gjatë ciklit normal operativ të biznesit nëse kjo është më e gjatë).

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.12. Huamarrjet

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë, minus koston e transaksionit të ndodhur. Huamarrjet njihen në vazhdim me kosto të amortizuar, duke u bazuar në metodën e interesit efektiv.

Huamarrjet janë klasifikuar si detyrime afatgjata vetëm nëse Shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e një detyrimi për të paktën 12 muaj pas datës së raportimit.

3.13. Të ardhurat nga shitja

3.13.1. Të ardhura nga shitja e mallrave

Të ardhurat nga shitja e mallrave maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, neto nga TVSH, akcizat, kthimet, skontimet dhe zbritjet. Të ardhurat do të njihen kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të pronësisë janë transferuar tek blerësi, marrja e përfitimeve është e mundur, kostot e lidhura me kthimin e mundshëm të mallrave mund të vlerësohen me besueshmëri, nuk ka përfshirje të vazhdueshme të drejtimit tek mallrat dhe sasia e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Transferimi i rreziqeve dhe përfitimeve ndryshon në varësi të kushteve të kontratës së shitjes. Transferimi zakonisht ndodh kur produkti arrin në magazinën e klientit.

3.13.2. Komisionet

Kur Shoqëria vepron më tepër si një agjent sesa si palë kryesore në një transaksion, të ardhurat e njohura janë shumat neto të komisioneve të marra nga Shoqëria.

3.14. Përfitimet e punonjësve

Skema me kontribute të përcaktuara

Një skemë me kontribute të përcaktuara është një skemë përfitimi pas punësimit në të cilën një Shoqëri pagan kontribute fikse në një njësi të veçantë pa asnjë detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar shumën të tjerë shtesë. Detyrimet për kontribute në skemat e pensioneve me kontribute të përcaktuara, si fondi i pensionit të shtetit shqiptar, njihen në fitim ose humbje kur ka lindur detyrimi për t'i paguar.

Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve vlerësohen të paskontuara dhe njihen si shpenzim kur shërbimi përkatës kryhet. Një detyrim do të njihet për shumën që pritet të paguhet nga përfitimet afatshkurtra nëse Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të siguruara nga punonjësi dhe detyrimi mund të vlerësohet me besueshmëri.

3.15. Qiratë

Qiratë, në të cilat një pjesë e rëndësishme e rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë mbahen nga qiradhënësi, klasifikohen si qira operative. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në fitim ose humbje me metodën lineare përgjatë jetës së qirasë. Nxitjet e marra për qiratë njihen si pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, përgjatë kohëzgjatjes së qirasë.

3. Përmbledhja e politikave kryesore kontabël (vazhdim)
3.16. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara dhe fitimet nga këmbimi në monedha të huaja. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen në fitime ose humbje, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huamarrjet dhe humbjet nga këmbimi në monedha të huaja. Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi në monedha të huaja paraqiten në shumën neto.

3.17. Kompensimi

Aktivët dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera rezultuese neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, vetëm kur ka një të drejtë ligjore detyruese për kompensimin e këtyre vlerave dhe kur Shoqëria ka për qëllim të bëjë shlyerjen e tyre mbi baza neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimet në të njëjtën kohë.

3.18. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në fitim ose humbje përveç rastit kur lidhet me zërat që njihen drejtpërdrejtë në kapital, rast në të cilin do të njihen në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm të mbartur nga vitet e kaluar.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, që bazohet mbi diferencat e përkohshme të krijuara ndërmjet vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që priten të aplikohen mbi diferencat e përkohshme kur ato rimerren, bazuar në ligjet që janë në fuqi në datën e raportimit. Aktivët dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ka një të drejtë ligjore për të kompensuar aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale dhe lidhen me tatimin mbi fitimin të vendosur nga i njëjti autoritet tatimor.

Njohja e aktiveve tatimore të shtyra

Aktiv i tatimor i shtyrë përfaqëson tatimin mbi të ardhurat e rikuperueshme nëpërmjet zbritjeve të ardhshme nga fitimet e tatueshme dhe paraqitet në bilanc. Aktivet tatimore të shtyra regjistrohen në masën që realizimi i përfitimit tatimor të jetë i mundur. Fitimet e ardhshme të tatueshme dhe përfitimet nga tatimet bazohen në planet e biznesit afatmesme të bëra nga drejtimi duke ekstrapoluar për periudhën e caktuar. Plani i biznesit bazohet në pritshmëritë e bordit drejtues, të cilat vlerësohen të jenë arsyeshme në bazë të kushteve. Për të qënë të kujdesshëm dhe në kontekstin e kushteve aktuale ekonomike dhe të tregut, drejtuesit e Shoqërisë nuk kanë njohur aktive tatimore të shtyra siç është detajuar në shënimin numër 6.

Pozicione të pasigurta tatimore

Pozicionet e pasigurta tatimore të Shoqërisë shqyrtohen nga menaxhimi në fund të çdo periudhe raportimi. Menaxhimi krijon detyrime për pozicione tatimore që vlerëson si më të mundshmet për t'u kundërshtuar nga autoritetet dhe për të rezultuar me vlerësimin të detyrimeve tatimore shtesë. Parashikimi bazohet në interpretimin e legjislacionit tatimor në fuqi ose që do të hyjë në fuqi në fund të periudhës së raportimit, si dhe mbi rregulloret të tjera ligjore ose gjyqësore lidhur me këto çështje. Detyrimet për gjoba, interesa dhe taksa të tjera përveç atyre mbi të ardhurat njihen bazuar në parashikimet e menaxhimit për shpenzimet që duhen për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese.

3.19. Ndryshime në paraqitje

Shifrat krahasuese rregullohen, kur është e nevojshme, për të qënë në përputhje me paraqitjen e shumave përkatëse në vitin aktual. Në këto pasqyra financiare nuk ka rregullime të tilla.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Menaxhimi i rrezikut është një element thelbësor në aktivitetet e Shoqërisë. Rreziqet më të mëdha që ka Shoqëria janë ato të lidhura me rrezikun e tregut, (që përfshijnë çmimin, normën e interesit dhe rrezikun e monedhës), rrezikun e kreditit dhe rrezikun e likuiditetit.

4.1. Procedurat dhe politikat e menaxhimit të rrezikut

Politikat e menaxhimit të riskut të Shoqërisë kanë për qëllim të identifikojnë, analizojnë dhe menaxhojnë rrezikun me të cilin përballlet Shoqëria, për të vendosur limitet dhe kontrollet e duhura për rreziqet, dhe të monitorojë vazhdimisht nivelet e rrezikut dhe përputhshmërinë me limitet. Politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara dhe praktikatat e reja më të mira.

Drejtimi i Shoqërisë në bashkëpunim me strukturat e menaxhimit të rrezikut të grupit dhe të mbikqyrur nga grupi, ka përgjegjësi mbi problemet e strukturës së menaxhimit të rrezikut, duke mbikqyrur menaxhimin e rreziqeve kryesore, duke rishikuar politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut si dhe duke aprovuar transaksionet që përfshijnë shuma të rëndësishme.

Funksioni i menaxhimit të rrezikut i referohet rrezikut financiar, rrezikut operacional dhe rrezikut ligjor. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit dhe rreziqe të tjera të çmimeve), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit.

Objektivat kryesore të menaxhimit të rrezikut financiar janë përcaktimi i limiteve të rrezikut, dhe të sigurojë që ekspozimi ndaj rreziqeve të jetë brenda këtyre limiteve. Funksioni i menaxhimit të rrezikut operacional dhe ligjor është që të mundësojnë funksionimin e duhur të procedurave dhe politikave të brendshme, në mënyrë që të minimizohen rreziqet operationale dhe ligjore. Faktorët e rrezikut të jashtëm dhe të brendshëm identifikohen dhe menaxhohen përmes strukturës organizative të Shoqërisë, dhe veçanërisht nga strukturat e menaxhimit të rrezikut në nivel grupi.

4.2. Rreziku financiar

4.2.1. Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që lëvizjet në çmimet e tregut, duke përfshirë edhe kurset e këmbimit dhe normat e interesit, do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë. Rreziku i tregut përfshin rrezikun e monedhës dhe rrezikun e normës së interesit, meqenëse Shoqëria nuk është e ekspozuar ndaj instrumenteve të kapitalit dhe rreziqeve të lidhura me të. Rreziku i tregut rrjedh nga pozicionet e hapura në normat e interesit dhe në monedhë të huaj që janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve specifike dhe të përgjithshme të tregut dhe ndryshimit të nivelit të paqëndrueshmërisë së çmimeve të tregut. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe të kontrollojë ekspozimet e rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin e rrezikut.

Shoqëria zotëron aktive dhe detyrime në monedhën Euro. Rreziku i kursit të këmbimit është i pranishëm kur aktivet aktuale ose të parashikuara në monedhë të huaj janë më shumë ose më pak se detyrimet në atë monedhë. Impakti i rrezikut të kursit të këmbimit të Shoqërisë është e kufizuar duke qenë se transaksionet janë të kufizuara në monedhat Lekë dhe Euro.

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit në monedhë të huaj, bazuar në vlera nominale, është si me poshtë.

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
4.2. Rreziku financiar (vazhdim)
4.2.2 Rreziku i kursit të këmbimit

31 dhjetor 2014

	Euro	Lekë	Totali
Aktivitet financiar			
Llogari të arkëtueshme	-	902,388,894	902,388,894
Të drejta të tjera	18,570,372	50,719	18,621,091
Mjete monetare	109,169,761	229,578,201	338,747,962
Totali i aktiveve financiare	127,740,133	1,132,017,814	1,259,757,947
Detyrimet financiare			
Hua	-	765,290,216	765,290,216
Llogari të pagueshme	92,620,133	19,068,041	111,688,174
Detyrime të tjera	2,608,598	93,548,845	96,157,443
Totali i detyrimeve financiare	95,228,731	877,907,102	973,135,833
Pozicioni financiar neto	35,511,402	254,110,712	286,622,114

31 dhjetor 2013

	Euro	Lekë	Totali
Aktivitet financiar			
Llogari të arkëtueshme	-	1,491,905,892	1,491,905,892
Të drejta të tjera	18,812,175	881,271	19,693,446
Mjete monetare	195,352	1,956,435	2,151,787
Totali i aktiveve financiare	19,007,527	1,494,743,598	1,513,751,125
Detyrimet financiare			
Hua	-	552,273,071	552,273,071
Llogari të pagueshme	333,327,706	292,881,581	626,209,287
Detyrime të tjera	2,679,926	48,556,290	51,236,216
Totali i detyrimeve financiare	336,007,632	893,710,942	1,229,718,574
Pozicioni financiar neto	(317,000,105)	601,032,656	284,032,551

Një rritje/ulje me 1% në kursin e këmbimit të Lekut përkundrejt një njësie të monedhës së huaj do të kishte impakt në fitim ose humbje me një rritje/ulje prej 335,114 Lekë (2013: 3,170,000 Lekë).

4.2.3 Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që lëvizjet në normat e interesit do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose në vlerën e portofolit të instrumenteve financiarë. Megjithatë, Shoqëria nuk ka aktive që mbartin rrezik të rëndësishëm, të ardhurat e Shoqërisë dhe flukset operative janë kryesisht të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Ndryshimet në normat e interesit ndikojnë fillimisht në huamarrjet me normë interesi fikse duke ndryshuar vlerën e tyre të drejtë.

Drejtimi nuk ka një politikë formale që përcakton se sa huamarrje duhet të jenë me normë interesi fikse apo variabël. Megjithatë, kur merren hua të reja drejtimi përdor gjykimin e tij për të vendosur nëse beson se një normë interesi fikse ose variabël do të jetë më e përshtatshme për Shoqërinë gjatë periudhës së pritshme deri në maturim.

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
4.2. Rreziku financiar (vazhdim)
4.2.3 Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

31 dhjetor 2014	Mbartin interes			Nuk mbartin interes	Totali
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj		
Aktivët financiarë					
Llogari të arkëtueshme					
Të drejta të tjera					
Mjete monetare				902,388,894	902,388,894
Totali i aktiveve financiare	338,747,962	-	-	18,621,091	338,747,962
	338,747,962	-	-	921,009,985	1,259,757,947
Detyrimet financiare					
Hua	765,290,216	-	-	-	765,290,216
Llogari të pagueshme	-	-	-	111,688,174	111,688,174
Detyrime të tjera	-	-	-	96,157,443	96,157,443
Totali i detyrimeve financiare	765,290,216	-	-	207,845,617	973,135,833
Pozicioni financiar neto	(426,542,254)	-	-	713,164,368	286,622,114

31 dhjetor 2013	Mbartin interes			Nuk mbartin interes	Totali
	Deri në 6 muaj	6 deri 12 muaj	Më shumë se 12 muaj		
Aktivët financiarë					
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	1,491,905,892	1,491,905,892
Të drejta të tjera	-	-	-	19,693,446	19,693,446
Mjete monetare	-	-	-	-	-
Totali i aktiveve financiare	2,151,787	-	-	1,511,599,338	1,513,751,125
	2,151,787	-	-	1,511,599,338	1,513,751,125
Detyrimet financiare					
Hua	552,273,071	-	-	-	552,273,071
Llogari të pagueshme	-	-	-	626,209,287	626,209,287
Detyrime të tjera	-	-	-	51,236,216	51,236,216
Totali i detyrimeve financiare	552,273,071	-	-	677,445,503	1,229,718,574
Pozicioni financiar neto	(550,121,284)	-	-	834,153,835	284,032,551

Në datën e raportimit, normat e interesit për instrumentet financiare që mbartin interes për Shoqërinë janë si në vazhdim:

Huatë	Vlera e mbetur më 31 dhjetor	
	2014	2013
	765,290,216	552,273,071
	765,290,216	552,273,071

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.3. Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjeve financiare për Shoqërinë nëse një klient ose palë kontraktuale në një instrument financiar nuk mund të plotësojë detyrimet e veta. Ekspozimi i Shoqërisë kundrejt rrezikut të kreditimit influencohet kryesisht nga karakteristikat individuale të klientit të saj të vetëm.

Në datën e raportimit, Shoqëria nuk pret ndonjë humbje nga mospërbushja e detyrimeve nga klienti i saj i vetëm. Ky i fundit ka siguruar një kolateral prej 1,000,000 Euro (140,200,000 Lekë) të depozituar pranë Raiffeisen Bank si garanci për shitjen dhe shpërndarjen e produkteve të Shoqërisë sipas marrëveshjes përkatëse. Gjithashtu, Shoqëria ka siguruar një kontratë sigurimi si një kolateral shtesë për stokun e mbajtur nga distributori, stok i cili shërben gjithashtu si kolateral për llogaritë e arkëtueshme të pashlyera në datën e raportimit. Vlera neto e realizueshme e inventarit të klientit që shërben si kolateral për llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë është 353,131 mijë lekë (2013: 1,280,874 mijë lekë). Për më tepër, Shoqëria mund të kompensojë detyrimet ndaj klientit në qoftë se nuk i përmbush dt detyrimet.

Ekspozimi maksimal i Shoqërisë ndaj rrezikut të kredisë reflektohet në vlerën e aktiveve.

	Dhjetor	
	2014	2013
Llogaritë të arkëtueshme	902,388,894	1,491,905,892
Llogari të tjera të arkëtueshme	18,621,091	19,693,446
Mjete monetare dhe ekuivalente	338,747,962	2,151,787
	1,259,757,947	1,513,751,125

Klienti i vetëm i Shoqërisë, Shoqëria vendase Tobacco Holding Group (THG) përbën vlerën prej 902,389 mijë Lekë (2013: 1,491,906 mijë Lekë) të llogarive të arkëtueshme (e cila është vlera neto pas provizionimit për zhvlerësim në shumën 34,791 mijë lekë) me 31 dhjetor 2014 (2013 : 32,772 mijë leke).

Me 31 dhjetor 2014, llogaritë të arkëtueshme dhe zhvlerësimi përkatës paraqiten si në vijim:

31 dhjetor 2014	Të arkëtueshme brenda 30 ditëve	Të arkëtueshme midis 31 dhe 120 ditëve	Llogarive të arkëtueshme për inventar të dëmtuar	Totali
Llogari të arkëtueshme		902,388,894	34,791,575	935,161,189
Fatura të pritshme kreditor	-	-	(34,791,575)	(34,791,575)
Totali	-	902,388,894	-	902,388,894

31 dhjetor 2013	Të arkëtueshme brenda 30 ditëve	Të arkëtueshme midis 31 dhe 120 ditëve	Llogarive të arkëtueshme për inventar të dëmtuar	Totali
Llogari të arkëtueshme	151,258,278	1,340,647,614	32,772,295	1,524,678,187
Fatura të pritshme kreditor	-	-	(32,772,295)	(32,772,295)
Totali	151,258,278	1,340,647,614	-	1,491,905,892

Shoqëria pret të lëshojë faturat për të kredituar afërsisht sa vlera e llogarive të arkëtueshme të lidhura me inventarin e dëmtuar që i është shitur distributorit. Fatura mund të lëshohet kur autoritetet tatimore marrin pjesë në shkatërrimin e inventarit të dëmtuar.

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

4. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

4.4. Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria nuk do të përmbushë detyrimet e saj kur ato maturohen. Politika e Shoqërisë për të menaxhuar likuiditetin është të sigurojë, sa më shumë që të jetë e mundur, se do të ketë gjithmonë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj kur ato maturohen, në kushte normale dhe të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme ose rrezikuar reputacionin e saj.

Zakonisht Shoqëria sigurohet se ka likuiditet të mjaftueshëm për të përballuar shpenzimet e pritshme operacionale, duke përfshirë shlyerjen e detyrimeve financiare. Kjo përjashton ndikimin potencial të rrethanave ekstreme që nuk mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, të tilla si katastrofat natyrore. Struktura e maturitetit të detyrimeve financiare të Shoqërisë në bazën e pagesave kontraktuale të paskontuara është prezantuar si më poshtë:

31 dhjetor 2014	6 muaj ose më pak	Midis 6 muaj e një vit	Më tepër se një vit	Totali
Detyrimet financiare				
Huatë	765,290,216	-	-	765,290,216
Llogari të pagueshme	111,688,174	-	-	111,688,174
Detyrime të tjera	96,157,443	-	-	96,157,443
Totali i detyrimeve financiare	973,135,833	-	-	973,135,833

31 dhjetor 2013	6 muaj ose më pak	Midis 6 muaj e një vit	Më tepër se një vit	Totali
Detyrimet financiare				
Huatë	552,273,071	-	-	552,273,071
Llogari të pagueshme	626,209,287	-	-	626,209,287
Detyrime të tjera	51,236,216	-	-	51,236,216
Totali i detyrimeve financiare	1,229,718,574	-	-	1,229,718,574

4.5. Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë ruajtja e aftësisë së Shoqërisë sipas parimit të vijimësisë në mënyrë që të sigurojë një fitim për aksionerët dhe të mbajë një strukturë optimale të kapitalit për të ulur koston e tij. Kapitali total llogaritet si pjesa e kapitalit të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar plus borxhin neto. Borxhi neto llogaritet si totali i huave paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar minus mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre.

Për të ruajtur apo përshtatur strukturën e kapitalit, Grupi mund të përshtatë sasinë e dividendit të paguar aksionerëve, mund t'i rikthejë kapital aksionarëve, mund të nxjerrë aksione të reja apo të shesë aksione për të zvogëluar borxhet.

Shoqëria është financuar me kapitalin minimal dhe kryesisht me hua dhe detyrime të tjera të pagueshme me palët e lidhura. Politikat e aplikuara synojnë që Shoqëria të jetë në gjendje të paguajë borxhet dhe detyrimet në lidhje me shpenzimet në investimet kapitale kur ato maturohen.

Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë kërkesë të jashtme të lidhur me kapitalin.

5. Përdorimi kritik i gjykimeve dhe vlerësimeve në zbatimin e politikave kontabël

Shoqëria bën parashikime dhe hamëndësime që ndikojnë në vlerat e njohura në pasqyrat financiare si dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve për periudhën e ardhshme financiare. Parashikimet dhe gjykimet vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në eksperiencën e drejtimit si dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë e evenimenteve në të ardhmen që mendohen të arsyeshme në këto rrethana. Drejtimi bën disa gjykime, përveç atyre që përfshihen në parashikime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykime që kanë ndikim të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare dhe parashikime që mund të shkaktojnë rregullime për vlerën e aktiveve dhe detyrimeve për periudhën e ardhshme financiare përfshijnë pikat në vijim.

5.1. Njohja e të ardhurave

Drejtimi i Shoqërisë ka njohur të ardhurat me vlerë 1,347,698 mijë lekë nga shitja e mallrave drejt distributorit të vetëm THG gjatë 2014 (2013: 1,917,791 mijë lekë). Shoqëria ka të drejtë të marrë mbrapsht produkte të shitura tek THG në rast se shitja e këtyre produkteve bie në konflikt me produkte më të reja të saj, strategjitë e markës apo të tregut ku ajo operon, në rast se THG do i ketë këto produkte në stok. Drejtimi beson se, bazuar në eksperiencat e mëparshme me shitje të ngjashme, përqindja e kthimeve nuk do të kalojë 2%. Për këtë arsye drejtimi ka njohur të ardhurat nga ky transaksion duke ngritur njëkohësisht një provizion për kthimet e vlerësuar detajuar në shënimin shpjegues 10.

5.2. Njohja e aktivitetit të shtyrë tatimor

Aktiviteti tatimor i shtyrë përfaqëson tatimin mbi të ardhurat që mund të rikuperohet nëpërmjet zbritjeve në të ardhmen nga të ardhurat e tatueshme dhe regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar. Përllogaritja e tatimit të shtyrë bëhet në ato shifra që mund të jetë e realizueshme. Të ardhurat e tatueshme në të ardhmen dhe shuma e përfitimeve të taksave që janë të realizueshme në të ardhmen bazohen në terma mesatare të planit të biznesit përgatitur nga drejtimi. Plani i biznesit bazohet në pritshmërinë e drejtimit që konsiderohet si e arsyeshme në bazë të rrethanave. Për të qenë të kujdesshëm dhe në përputhje të kushteve aktuale ekonomike dhe konditave të tregut, drejtimi nuk ka njohur aktivitetin tatimor të shtyrë të detajuar në shënimin shpjegues 8.

Drejtimi është i mendimit se nuk do njohë rimarrjen e aktivitetit të shtyrë tatimor në kontekstin e mjedisit aktual ekonomik, ku fitimi i parashikuar aktual dhe i ardhshëm është ndikuar negativisht nga situata e tregut dhe është karakterizuar nga luhatje të shpeshta.

5.3. Parimi i vijimësisë

Drejtimi i Shoqërisë përgatiti këto pasqyra financiare në parimin e vijimësisë. Në kryerjen e këtij vlerësimi, drejtimi mori në konsideratë pozicionin financiar të Shoqërisë, planet afatshkurtra, fitueshmërinë e operacioneve dhe aksesin ndaj burimeve financiare, dhe analizoi impaktin e krizës financiare të fundit mbi operacionet e ardhshme të Shoqërisë. Pavarësisht vështirësive të tanishme financiare (shënimi 2), drejtimi i Shoqërisë është i bindur se ajo do të jetë në gjendje për të financuar kërkesat e kapitalit të punës nëpërmjet flukseve të parasë të brendshme dhe menaxhimit të kushteve të kredisë me furnizuesit kryesorë dhe Shoqërive të Grupit. Shoqëria mëmë e Shoqërisë ka për qëllim të mbështesë Shoqërinë në arritjen e objektivave të saj dhe të vazhdojë të punojë në Shqipëri në të ardhmen e parashikueshme. Si e tillë, pavarësisht nga treguesit negative financiare, të cilat mund të hedhin dyshime të konsiderueshme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, drejtimi beson se me mbështetjen e Shoqërisë mëmë, është e përshtatshme për të përgatitur këto pasqyra financiare mbi parimin e vijimësisë.

5.4. Llogaritë e arkëtueshme - zhvlerësimi

Shoqëria përcakton se llogaritë e arkëtueshme tregtare zhvlerësohen kur ka një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur në lëvizjen e inventarit të klientit të saj të vetëm. Për më tepër, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm kur ka përkeqësim në shëndetin financiar të klientëve, industrisë dhe performancës së sektorit, ose të flukseve monetare operative apo të financimit. Në këtë rast, kërkohet gjykim për të përcaktuar provizionin për zhvlerësimin. Në marrjen e këtij vendimi, Shoqëria vlerëson midis të tjerash parashikimin e kërkesës për tremujorin për tv përcaktuar flukset monetare operative të klientit të mundshme për të ripaguar borxhin dhe nivelin e garancisë prej 1,000 mijë Euro të lëshuar nga klienti i vetëm (THG) dhe vlera e drejtë e kolateralit (inventari në gjendje të klientit të vetëm) për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2014 është 353,153 mijë lekë (2013: 1,076,108 mijë Lekë).

6. Standardet e reja dhe interpretimet

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme u bene efektive për Shoqërinë që prej 1 Janar 2014:

"Kompensimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare"-Amendime të SNK 32 (publikuar në dhjetor të 2011 dhe efektive për periudha vjetore që nisin në ose pas 1 janar 2014). Amendimi shtoi një guidë për aplikimin e SNK 32 për të adresuar mospërputhjet e identifikuar në aplikimin e disa kriterëve të kompensimit. Kjo përfshin qartësimin e "një të drejte të zbatueshme me ligj për kompensim" dhe disa sisteme kompensimi bruto mund të konsiderohen ekuivalente për kompensimin neto. Standardi qartësoi se një e drejtë kualifikuese për të kompensuar: (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë e zbatueshme ligjërisht në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast të ngjarjes e mospagimit dhe (iii) në rastin e paaftësisë paguese ose falimentimit. Standardi i ndryshuar nuk kishte një ndikim thelbësor në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

"Amendimet ndaj SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27-Entitetet investuese" (publikuar më 31 tetor 2012 dhe efektive për periudha vjetore që nisin në 1 janar 2014). Amendimi prezantoi një përkufizim të një Shoqërie investuese si një entitet që: (i) merr fonde nga investitorët me qëllim për ti ofruar atyre shërbimet e menaxhimit të investimeve, (ii) angazhohet tek investitorët e saj se qëllimi i tij i biznesit është që të investojë fonde vetëm për vlerësimin e kapitalit ose për të siguruar të ardhura nga investimet dhe (iii) mat dhe vlerëson investimet e veta me bazë vlerën e drejtë. Një Shoqërie investimi i kërkohet të japë llogari për degët e saj me vlerën të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, dhe të konsolidojë vetëm ato filiale që ofrojnë shërbime që janë të lidhura me aktivitetet investuese të njësisë ekonomike. SNRF 12 është amenduar për të prezantuar shënime shpjeguese të reja, duke përfshirë çdo gjykim domethënës të bërë për të përcaktuar nëse një njësi ekonomike është një entitet investues dhe për të marrë çdo informacion në lidhje me mbështetjen financiare ndaj një filiali të pakonsoliduar, pavarësisht nëse i është dhënë tashmë apo është si qëllim ti jepet filialit. Standardi i ndryshuar nuk kishte një ndikim thelbësor në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

BISNK 21 – "Taksat" (lëshuar ne 20 maj 2013 dhe e bere efektive per periudhat vjetore me fillim ne 1 janar 2014). Interpretimi sqaron kontabilizimin per nje detyrim per te paguar nje takse qe nuk eshte tatim fitimi. Ngjarja qe sjell kete detyrim eshte ngjarja e identifikuar nga legjislacioni qe sjell obligimin per pagimin e detyrimit. Fakti qe nje entitet eshte ekonomikisht e gatshme tvazhdoje ne periudha te ardhshme, ose qe perгатit pasqyrat financiare duke u bazuar ne parimin e vijismshmerise, nuk krijon nje obligim. E njëjta njohje e parimeve aplikohet ne pasqyrat financiare të ndërmjetshme apo vjetore. Aplikimi i interpretimeve ndaj detyrimeve nga skemat e emetimit të gazrave është opsionale. Interpretimi nuk kishte një ndikim të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Amendimet ndaj SNK 36-"Dhënia e informacioneve shpjeguese për shumën e rikuperueshme të aktiveve jo-financiare" (të publikuara në maj 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2014; ky aplikim më herët është lejuar nëse SNRF 13 zbatohet për të njëjtin sistem kontabël dhe periudhë krahasuese). Amendimet heqin kërkesën për të njohur shumën e rikuperueshme kur një NJGJM përmban emër të mirë ose aktive afatgjata jo-materiale me jetëgjatësi të pakufizuar, por nuk ka pasur asnjë zhvlerësim. Standardi i ndryshuar nuk kishte një ndikim të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Amendimet ndaj SNK 39-"Rinovim i derivateve dhe Vazhdimi i Kontabilizimit të mbrojtjes" (të publikuara në qershor 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2014). Amendimet lejojnë kontabilitetin mbrojtës për të vazhduar në një situatë ku një derivat, i cili ka qenë i caktuar si një instrument mbrojtës, është rinovuar (d.m.th. palët kanë rënë dakord për të zëvendësuar palën e tyre origjinale me një të re) për të kryer pastrimin me një palë qendrore si rezultat i ligjeve dhe rregulloreve, nëse janë plotësuar disa kushte specifike. Standardi i ndryshuar nuk kishte një ndikim të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë.

6. **Standardet e reja dhe interpretimet (vazhdim)**

Disa standarte të reja dhe interpretimet përkatëse janë të detyrueshme për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2015 të cilat shoqëria nuk i ka implementuar më herët.

SNRF 9 "Instrumentet Financiare: Klasifikimi dhe Matja" (i ndryshuar në korrik 2014 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018). Karakteristikat kryesore të standardit të ri janë:

- Aktivet financiare duhet të klasifikohen në tri kategori të matjes: ato që duhet të maten më pas me koston e amortizuar, dhe më tej me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDTAGJ) dhe ato që duhet të maten më pas me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDFH).
- Klasifikimi për instrumentet e borxhit është i drejtuar nga modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e aktiveve financiare dhe nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale përfaqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit (VPPI). Nëse një instrument borxhi është mbajtur për tu mbledhur, ai mund të mbahet me koston e amortizuar nëse ai gjithashtu përmbush kërkesat VPPI. Instrumentet e borxhit që plotësojnë kërkesat VPPI që janë mbajtur në një portofol ku njësisë ekonomike edhe mban aktive për të mbledhur flukset monetare të tyre dhe shet aktive mund të klasifikohen si VDTAGJ. Aktivet financiare që nuk përmbajnë flukse monetare që janë të VPPI duhet të maten me VDFH (për shembull, derivatet). Derivatet e përfshirë nuk janë të ndara nga aktivet financiare por do të përfshihen në vlerësimin e gjendjes së VPPI.
- Investimet në instrumente të kapitalit maten gjithmonë me vlerën e drejtë. Megjithatë, menaxhimi mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur ndryshime në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse, me kusht që instrumenti nuk është i mbajtur për tregtim. Nëse instrumenti i kapitalit të vet është i mbajtur për tregtim, ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në fitim ose humbje.
- Pjesa më e madhe e kërkesave të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë mbartur të pandryshuara sipas SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që njësisë duhet të paraqesë efektet e ndryshimeve në rrezikun kreditor të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në të ardhurat gjithëpërfshirëse.
- SNRF 9 paraqet një model të ri për njohjen e humbjeve nga zhvlerësimi – Modeli i Humbjeve të Pritshme të Kredisë (HPK). Kjo është një përjasje në 'tre faza' e cila është e bazuar në ndryshimin e cilësisë së kredisë së aktiveve financiare që prej njohjes fillestare. Në praktikë, rregullat e reja kërkojnë që njësitë ekonomike të regjistrojnë një humbje të menjëhershme të barabartë me HPK 12 mujore, në njohjen fillestare të aktiveve financiare që nuk janë të zhvlerësuar (ose HPK e të gjithë jetëgjatësisë për llogari të arkëtueshme tregtare). Aty ku ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë, zhvlerësimi matet duke përdorur HPK e të gjithë jetëgjatësisë dhe jo HPK 12 mujore. Modeli përfshin thjeshtësimet operacionale për qiratë dhe llogaritë tregtare të arkëtueshme.
- Kërkesat nga kontabiliteti mbrojtës janë amenduar që të pershtatin kontabilitetin me menaxhimin e riskut. Standardi ofron për entitetet zgjedhje për politika kontabel mes aplikimit të kërkesave të kontabilitetit mbrojtës nga SNRF 9 apo me vazhdimin e aplikimit të SNK 39 sepse standardi momentalisht nuk adreson kontabilitetin makro të mbrojtjes.

Qartësimi i Metodave të pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 (publikuar më 12 maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar-it 2016). Ky ndryshim sqaron parimin e SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale dhe SNK 38 Aktivet Jo -materiale, ku të ardhurat pasqyrojnë një model të përfitimeve ekonomike që janë të gjeneruara nga veprimtaria e një biznesi (ku aktiviteti bën pjesë) në vend të përfitimeve ekonomike që konsumohen përmes përdorimit të aktivitetit. Si rezultat, raporti i të ardhurave i krijuar mbi të ardhurat e përgjithshme të pritshme për t'u gjeneruar nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar aktivet afatgjata material, por mund të përdoret vetëm në raste shumë të rralla për të amortizuar aktivet jo-materiale.

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

6. Standardet e reja dhe interpretimet (vazhdim)

Deklarimet e reja në vijim nuk priten të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë kur të miratohen:

- Ndryshimet në SNK 19 - "Skemat e përfitimeve të përcaktuara: Kontributet e punonjësve" (publikuar në nëntor 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në 1 korrik 2014).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të e 2012 (publikuar në dhjetor 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në apo pas 1 korrik-ut 2014).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të e 2013 (publikuar në dhjetor 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në apo pas 1 korrik-ut 2014).
- SNRF 14, Llogaritë rregullatore shtyrëse (publikuar në janar 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar-it 2016).
- Kontabiliteti për Blerjet e Interesave në Operacione të Përbashkëta - Ndryshimet në SNRF 11 (publikuar më 6 maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë në ose pas 1 janar-it 2016).
- Qartësimi i Metodave të pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 (publikuar më 12 maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë në ose pas 1 janar-it 2016).
- SNRF 15, Të ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët (publikuar më 28 maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë në ose pas 1 janar-it 2017).
- Bujqësia: bimët prurësit - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 (publikuar në 30 qershor 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar-it 2016).
- Metoda e Kapitalit në Pasqyrat Financiare Individuale - Ndryshimet në SNK 27 (publikuar më 12 gusht 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në 1 janar 2016).
- Shitja apo Kontributi i Aktiveve mes një Investitori dhe bashkëpunëtori të tij ose sipërmarrje të përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar-it 2016).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të e 2014 (publikuar më 25 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar-it 2016).

Përveçse kur përcaktohet ndryshe, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë dukshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014
 (SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

7. Aktivet afatgjata materiale

Kosto	Pajisje zyre dhe mobilje	Pajisje elektronike	Mjete transporti dhe pajisje	Instalime dhe pajisje	Totali
Gjendja më 1 janar 2013					
Shtesa	15,898,527	29,282,083	53,815,085	375,194	99,370,889
Pakësime	129,137	3,458,273	2,611,530	12,799	6,211,739
Gjendja më 31 dhjetor 2013	16,027,664	32,740,356	56,426,615	387,993	105,582,628
Shtesa	630,123	306,035	7,288,175	-	8,224,333
Gjendja më 31 dhjetor 2014	(7,454,576)	(14,816,314)	(7,290,097)	(118,503)	(29,679,490)
	9,203,211	18,230,077	56,424,693	269,490	84,127,471
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2013	(13,716,749)	(23,315,069)	(31,837,183)	(308,751)	(69,177,752)
Shpenzimi i periudhës	(689,894)	(1,975,352)	(6,042,198)	(27,288)	(8,734,732)
Pakësime	(14,406,643)	(25,290,421)	(37,879,381)	(336,039)	(77,912,484)
Gjendja më 31 dhjetor 2013	(608,201)	(2,636,156)	(6,347,466)	-	(9,591,823)
Shpenzimi i periudhës	7,382,453	14,788,923	7,290,098	118,503	29,579,977
Gjendja më 31 dhjetor 2014	(7,632,391)	(13,137,654)	(36,936,749)	(217,536)	(57,924,330)
Vlera kontabël neto					
Më 31 dhjetor 2013	1,621,021	7,449,935	18,547,234	51,954	27,670,144
Më 31 dhjetor 2014	1,570,820	5,092,423	19,487,944	51,954	26,203,141

Shpenzimet e amortizimit janë paraqitur në zërin "Shpenzime administrative" në ftim / humbje.

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

8. Aktiv i shtyrë tatimor

Diferencat midis bazës kontabël dhe asaj tatimore shkaktojnë diferenca të përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllim të raportimit financiar dhe bazave të tyre tatimore. Diferencat e zbritshme të përkohshme të cilat nuk janë njohur detajuar në shënimin shpjegues 5.2.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Aktive afatgjata materiale		
Inventarët	(882,715)	(1,035,388)
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	547,242	600,631
Llogari të pagueshme dhe të tjera	5,218,736	4,915,844
	7,614,503	6,512,690
	13,380,481	12,029,165

	1 janar 2014	Tatimi i shtyrë i panjohur	31 dhjetor 2014
Aktive afatgjata materiale			
Inventari	(1,035,388)	152,673	(882,715)
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	600,631	(53,389)	547,242
Llogari të pagueshme dhe të tjera	4,915,844	302,892	5,218,736
	6,512,690	1,101,813	7,614,503
	12,029,165	1,404,705	13,380,481

Diferencat e përkohshme për Aktivet afatgjata material lidhen me përdorimin e normave të ndryshme amortizimi për efekte tatimore.

Diferencat e përkohshme të inventarit kanë të bëjnë me materialet promocionale të cilat trajtohen si inventar bazuar në rregulloret tatimore mbi tatim fitimin.

Provizionet për kredit notat mbi llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme njihen për llogari të tatim fitimit vetëm në momentin që ato lëshohen.

Shpenzimet e përlogaritura për detyrimet për palët e lidhura të përfshira në llogari të pagueshme dhe detyrime të tjera janë të zbritshme vetëm në momentin që ato janë marrë nga Shoqëria.

Vlerësimi i menaxhimit për mos-njohjen e diferencave të përkohshme të zbritshme është paraqitur në shënimin 5.2.

9. Inventarët

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Pulla fiskale	3,524,111	1,928,340
	3,524,111	1,928,340

Shoqëria blen pullat fiskale që u dërgohen fabrikave dhe u bashkangjiten paketave të cigareve. Në datën e raportimit, vlera e mësipërme përfaqëson vlerën e pullave fiskale të cilat janë ende tek fabrikat, matur në kosto (sasia e akcizës së paguar nga Shoqëria).

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

10. Llogari të arkëtueshme

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Llogari të arkëtueshme	937,180,469	1,524,678,187
Provizion nota krediti mbi llogaritë e arkëtueshme	(34,791,575)	(32,772,295)
	902,388,894	1,491,905,892

Llogaritë e arkëtueshme lidhen me distributorin e vetëm, Tobacco Holding Group SH.P.K.

Lëvizjet në provizionin për faturat kredituese mbi llogaritë e arkëtueshme gjatë periudhës janë si më poshtë:

	2014	2013
Më 1 janar		
Provizion për fatura kredituese	32,772,295	32,772,295
Më 31 dhjetor	(2,019,280)	-
	34,791,575	32,772,295

Provizioni për fatura kredituese përfaqëson vlerën e inventarit të vjetër të identifikuar. Inventari i vjetër duhet të shkatërrohet para se të lëshohet fatura kredituese. Në mënyrë që të ketë akcizën e paguar për aksionet e vjetra të rimbursuara, organet tatimore duhet njoftohen për shkatërrimin. Letrat e kreditit nuk lëshohen deri sa shkatërrimi i mallrave të kryhet në prani të përfaqësuesve të organeve tatimore.

11. Llogari të tjera të arkëtueshme

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura (Grupi BAT)	18,570,372	18,812,175
Të arkëtueshme nga punonjësit	50,719	881,271
Aktive financiare	18,621,091	19,693,446
Parapagime për akcizën	38,653,695	38,653,695
Parapagime ndaj furnitorëve	5,096,945	17,990,251
TVSH e arkëtueshme	13,880,396	537,526
Parapagime të tjera	215,437	414,250
Aktive jo-financiare	57,846,473	57,595,722
	76,467,564	77,289,168

12. Mjetet monetare dhe ekuivalente

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Llogari rrjedhëse me bankat	338,747,962	2,151,787
	338,747,962	2,151,787

Shoqëria ka llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank Albania dhe Societe Generale. Shumat janë vendosur në Euro me normë interesi 0.25% dhe në Lekë me një normë interesi 0.5% më 31 dhjetor 2014 (2013: 0.5% në euro dhe 1% në lekë). Banka (Societe Generale Albania) ka vlerësimin A-1+ për investime afatshkurtra në monedhë të huaj sipas S&P. Shoqëria ka vendosur të rrisë likuiditetin në llogaritë rrjedhëse në mënyrë që të suportoje rritjen e parashikuar të importeve dhe akcizës gjatë 2015.

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDREJSH)

13. Kapitali aksionar

	Numri i aksioneve	Vlera nominale në Lekë	Vlera në Lekë '000
Me 1 janar 2013			
Rritje	1,000	552,341	552,341
Më 31 dhjetor 2013			
Rritje	1,000	552,341	552,341
Me 31 dhjetor 2014			
	1,000	552,341	552,341

Më 31 dhjetor 2014, kapitali aksionar i Shoqërisë është 552,341 mijë Lekë i shpërndarë në 1,000 aksione, ku çdo aksion ka vlerën 552,341 Lekë. Kapitali është plotësisht i paguar.

Kapitali aksionar i Shoqërisë është i zotëruar 100% nga British American Tobacco International Holdings B.V. që bleu zotëruesin e mëparshëm të Shoqërisë, Rothmans Holdings Poland B.V., në shkurt 2014. Shoqëria mëmë është British American Tobacco plc, me qendër në Londër, Mbretëria e Bashkuar.

14. Huatë

Më 30 prill 2011 Shoqëria mori një hua nga British American Tobacco Western Europe Region B.B (BAT WER B.V.) në shumën 900,000 mijë Lekë (2013: 546,060 mijë Lekë) me normë interesi të ndryshueshme bono thesari shqiptare 3 mujore + 132 pikë bazë në vit. Kjo hua ka në tarifë angazhimi prej 35% të marzhit të tërhequr në vit mbi çdo vlerë të patërhequr. Kjo hua mbahet në Lekë pasi Shoqëritë ranë dakord që BAT WER B.V. do të mbulojë rrezikun e kursit të këmbimit në lidhje me këtë hua deri më 31 dhjetor 2015. Huaja matoron më 29 prill 2015.

Hua të marra
 Interesi i përlogaritur

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Hua të marra	759,800,000	546,060,000
Interesi i përlogaritur	5,490,216	6,213,071
	765,290,216	552,273,071

Vlera kontabël e huasë përafrohet me vlerën e saj të drejtë. Në datën e raportimit norma e interesit të huasë është 4.543% në vit (2013: 4.327% në vit).

Gjatë vitit 2014 Shoqëria kishte flukse monetare hyrëse nga huatë në vlerën 353,940,000 lekë dhe flukse monetare dalëse nga shlyerja e huave në vlerën 140,200,000 lekë.

Më 23 prill 2015, Shoqëria dhe BAT WER nënshkruan një marrëveshje për rinovimin e kontratës së huasë për shumën prej 620,000 mijë lekë, si një linjë overdrafti. Huamarrja matoron më 29 prill 2016 dhe ka një normë interesi bono thesari shqiptare 3 mujore TRIBOR + 2.850%.

15. Llogari të pagueshme

Furnitorë vendas për shërbime
 British American Tobacco Export BV
 BAT Vranje AD
 British American Shared Services
 BAT Maribor
 BAT Germany
 British American Tobacco EOOD
 British American Tobacco SEE d.o.o
 Të tjera

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Furnitorë vendas për shërbime	80,035,457	326,244,284
British American Tobacco Export BV	33,397,158	265,351,772
BAT Vranje AD	-	14,622,314
British American Shared Services	(2,360,013)	6,192,291
BAT Maribor	-	3,173,750
BAT Germany	-	2,556,154
British American Tobacco EOOD	615,572	589,870
British American Tobacco SEE d.o.o	-	395,427
Të tjera	-	7,083,425
	111,688,174	626,209,287

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

15. Llogari të pagueshme (vazhdim)

Për shkak të kërkesave të legjislacionit tatimor për TVSH-në, komisioni i pagueshëm ndaj THG (lekë 80,035,459 mijë) është i përfshirë në llogari të pagueshm si "furnitorë vendas për shërbime", dhe është paraqitur veçmas nga llogaritë e arkëtueshme. Llogaritë e pagueshme ndaj Shoqërive të grupit përbëhen nga blerjet e mallrave nga BAT Export B.V. Llogaritë e arkëtueshme nga British American Shared Services ka të bëjë me një notë krediti marrë.

16. Detyrime të tjera

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Shpenzimet e përlogaritura		
Tatimi mbi të ardhurat personale dhe kontributet shoqërore të punonjësve	95,172,326	50,060,620
	985,117	1,175,596
	96,157,443	51,236,216

17. Të ardhurat nga shitjet

Ligji i TVSH në fuqi kërkon që importuesit e duhanit (shitësit me shumicë) t'i faturojnë produktet shitësve me pakicë me çmimin përfundimtar. Si rezultat marzhi i shitësit ose distributorit i ngarkohet importuesit nëpërmjet një fature komisioni. Skema e faturimit të mëposhtëm është zbatuar për të qënë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Të ardhura nga shitja e cigareve	1,716,736,152	2,338,549,941
Minus: Komisioni i faturuar nga distributori	(369,038,600)	(420,758,962)
Të ardhura neto nga shitjet	1,347,697,553	1,917,790,979

18. Kosto e mallrave të shitur

Përveç çmimit të blerjes dhe kostove shtesë të transportimit të mallrave në vendodhjen përfundimtare, kostoja e mallrave të shitur përfshin edhe shpenzimin printimit të pullave fiskale dhe akcizën përkatëse të paguar.

19. Shpenzime tregtare dhe marketingu

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Shpenzime për tregtimin dhe mbështetjen e markës	35,304,955	153,149,968
Shpenzime personeli	13,210,940	29,762,071
Shpenzime jo të markës – shpenzime për tregtim	18,973,651	23,277,582
Shpenzime të ri-faturuara	(13,804,139)	(17,283,228)
	53,685,407	188,906,393

Shpenzimet e ri-faturuara kanë të bëjnë me shpenzimet e kryera për BAT Kosovë dhe Slloveni të cilat i janë ri-faturuar BAT Export B.V. Ato janë të lidhura kryesisht me orët e punës së stafit me eksperiencë të Shoqërisë që kanë punuar për llogari të këtyre Shoqërive.

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

20. Shpenzimet administrative

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Shpenzime për teknologjinë e informacionit	71,097,881	65,854,510
Shpenzime kërkimi dhe zhvillimi	-	64,059,682
Shpenzime të përgjithshme administrimi	48,965,699	31,851,454
Shpenzime të departamentit të financave	35,275,947	16,810,223
Shpenzime amortizimi	5,536,105	4,675,176
Shpenzime për burimet njerëzore	5,639,901	3,530,144
Shpenzime ligjore	6,470,851	8,959,918
Shpenzime të ri-faturuara	(52,223,055)	(44,771,900)
	120,763,329	150,969,207

Kostot e kërkimit dhe zhvillimit gjatë vitit 2013 janë të lidhura me shpenzimet e bëra në tregjet e reja të Grupit në Maqedoni dhe Bosnje Hercegovinë.

Këto shpenzime janë mbuluar nga Shoqëria duke qënë se nuk ka përfaqësues ligjor të BAT në këto vende dhe BAT Shqipëri është përgjegjëse për rajonin. Këto shpenzime nuk iu ri-faturuan BAT WER dhe u trajtuan si shpenzime të pazbritshme për arsye tatimore. Gjatë viti 2014 Shoqëria nuk pati kosto të tilla.

Shpenzimet IT janë rritur për shkak të implementimit të një projekti të ri gjatë 2014-së të quajtur TAO. Pjesë e këtyre shpenzimeve janë të rekuperueshme nga BAT BV zyra e përfaqësimit e Kosovës dhe BAT Maribor d.o.o për shpenzimet e lidhura me tregjet fundore të Kosovës dhe Sllovenis.

21. Të ardhura të tjera operative

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Fitimi neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	208,333	-
Fitimi neto nga shërbimet e ofruara degës se Kosovës dhe të rifaturuara BAT EXPORT B.V.	3,616,801	3,259,311
	3,825,135	3,259,311

Shoqëria faturon një marzh prej 6% mbi shpenzimet që i ri-faturohen BAT Export B.V. dhe BAT Slovenia d.o.o. (shënimi 19 dhe 20) për shpenzimet e kryera për llogari të BAT Kosovë dhe BAT Slovenia d.o.o..

22. Shpenzimet financiare neto

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Humbje nga kursi i këmbimit	(8,242,984)	(2,055,884)
Interesi i përfituar nga depozitat	1,614,972	1,716,269
Interesi për huatë	(35,205,858)	(27,977,978)
Shpenzimet financiare neto	(41,833,870)	(28,317,593)

23. Tatimi mbi fitimin

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	11,342,890	6,686,166
	11,342,890	6,686,166

Norma e tatimit mbi fitimin në Shqipëri për vitin 2014 është 15% (2013: 10%). Rakordimi i normës efektive të tatimit fitimit është si në vijim.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Fitimi para tatimit	12,031,768	(54,419,810)
Tatimi mbi fitimin me normën e aplikueshme prej 10%	1,804,766	(5,441,981)
Efekti i shpenzimeve të panjohura	9,538,124	12,128,147

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

11,342,890

6,686,166

24. Angazhime dhe detyrime të mundshme

Detyrime të kushtëzuara tatimore

Legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar në fuqi në fund të periudhës raportuese është subjekt interpretimesh të ndryshme kur zbatohet ndaj veprimeve dhe aktiviteteve të shoqërisë. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor i përcaktuar nga drejtimi dhe dokumentacioni formal i cili mbështet këtë pozicion mund të kundërshtohet nga autoritetet tatimore.

Periudhat fiskale mbeten të hapura për shqyrtim nga autoritetet për pesë vite kalendarike para vitit të shqyrtimit. Në rrethana të caktuara shqyrtimet mund të mbulojnë periudha edhe më të gjata. Duke qenë se legjislacioni tatimor mund të mos japë udhëzime të prera në fusha të caktuara, herë pas here, Shoqëria mund të përshtasë interpretimet e veta në lidhje me këto fusha. Ndërkohë që drejtimi vlerëson që pozicionet dhe interpretimet tatimore që ai ka ndërmarrë janë të arsyeshme, ekziston rreziku i daljeve të mundshme të burimeve në rast se këto qëndrime dhe interpretime kundërshtohen nga autoritetet tatimore përkatëse.

Veprimet ligjore

Ndonjëherë, dhe gjatë rrjedhës normale të biznesit, mund të ngrihen padi kundër Shoqërisë. Bazuar në vlerësimet e tij, drejtimi është i mendimit që nuk do të shkaktohen humbje materiale në lidhje me këto padi mbi provizionet e paraqitura në këto pasqyrat financiare.

Qiratë operationale të paanullueshme

Në rastet kur Shoqëria është qiramarrës, pagesat minimale të ardhshme të qirasë operationale të pa-anullueshme janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Më pak se një vit	4,133,000	4,133,000
Një deri në pesë vjet	12,401,000	16,534,000
Mbi pesë vjet	-	-
	16,534,000	20,667,000

25. Transaksione me palët e lidhura

Shoqëria mëmë është British American Tobacco International Holdings B.V. Hollandë, ndërsa Shoqëria që ka kontrollin përfundimtar mbi Shoqërinë është British American Tobacco p.l.c. Transaksionet me palët e lidhura të Shoqërisë janë si më poshtë:

Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014

Detyrimet

Hua (BAT WER B.V.)

Llogari të pagueshme

- BAT Export B.V.

- BAT Shared services GSD

- British American Tobacco EOOD

Totali i detyrimeve

Totali

765,290,216

33,397,158

(2,360,013)

615,572

796,942,933

Të ardhurat

Shërbimet e ofruara-ri-faturimi i shpenzimeve të Kosovës (BAT WER BV)

Shërbimet e ofruara-ri-faturimi i shpenzimeve të Sllovenisë (BAT Maribor d.o.o)

Totali i të ardhurave

2,788,101

828,701

3,616,802

Shpenzime

Blerja e mallrave BAT WER BV)

Shpenzime të tjera – Tarifë konsulence (BASS (GSD) Limited)

Shpenzime të tjera – Tarifë konsulence (BAT SEE)

Shpenzime të tjera – Tarifë konsulence (BAT EOOD)

Totali i shpenzimeve

386,815,656

65,990,280

1,742,213

1,603,175

456,151,324

British American Tobacco Albania sh.p.k.
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

(SHUMAT JANË NË LEK SHQIPTAR, NËSE NUK ËSHTË SPECIFIKUAR NDRYSHE)

25. Transaksione me palët e lidhura (vazhdim)

Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013

	Totali
Detyrimet	
Hua (BAT WEX BV)	552,273,071
Llogari të pagueshme	
- BAT Export B.V.	265,351,772
- BAT Vranje AD	14,622,314
- BAT Shared services GSD	6,192,291
- BAT Maribor d.o.o	3,173,750
- BAT Germany GmbH	2,556,154
- British American Tobacco EOOD	589,870
- British American Tobacco SEE d.o.o	395,427
Totali i detyrimeve	845,154,649

Të ardhura

Shërbimet e ofruara-ri-faturimi i shpenzimeve të Kosovës (BAT WER BV)	3,002,935
Shërbimet e ofruara- ri-faturimi i shpenzimeve të Sllovenisë (BAT Maribor d.o.o)	847,273
Totali i te ardhurave	3,850,208

Shpenzime

Blerja e mallrave (BAT WESTERN EUROPE REGION B.V.)	558,885,433
Shpenzime të tjera – Tarifë konsulence (BASS (GSD) Limited)	60,401,445
Totali i shpenzimeve	619,286,878

Huaja nga Shoqëria mëmë ka një normë interesi të ndryshueshme bono thesari shqiptare 3 mujore + 132 pikë bazë në vit (2013: 4.387%).

Transaksionet me drejtimin

Drejtuesit kryesorë janë ata persona që kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për planifikim, drejtim dhe kontroll të aktiviteteve të Shoqërisë, direkt ose jo, duke përfshirë manaxherin e përgjithshëm. Drejtuesit kryesorë kanë marrë shpërblimet e mëposhtme gjatë vitit të cilat janë përfshirë në shpenzimet për personelin:

	2014	2013
Shpenzime page dhe bonus	8,211,626	8,662,923
Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	317,565	186,367
	8,529,191	8,849,290

26. Ngjarjet pas datës së raportimit

Më 23 prill 2015, Shoqëria dhe BAT WER nënshkruan një marrëveshje për rinovimin e kontratës së huasë për shumën prej 620,000 mijë lekë, si një linjë overdrafti. Huamarrja maturon më 29 prill 2016 dhe ka një normë interesi bono thesari shqiptare 3 mujore TRIBOR + 2.850%.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që do të kërkonin rregullime apo shpjegime shtesë në këto pasqyrat financiare.